



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01/02	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	1424/2021
Nr. i faqeve Braj stranica No. pages:	7	Data Datum Date:	09.09.2021
Prishtinë/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera –
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 55

Datë: 09.09.2021

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr këtë:

V E N D I M

mbi

caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjeshëm të masës 3.5 – Shtesat për Fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike

A. FORMA E SUBVENCIONIMIT

1. Vlera e subvencionimit do të jetë si vijon:
 - 1.1. Për fëmijët nën moshën 16 vjeç, mbështetja do të jetë 10 € (dhjetë euro) në muaj;
 - 1.2. Për fëmijët e moshës 0-24 muaj, mbështetja do të jetë 20 € (njëzetë euro) euro në muaj;
2. Skema e shtesave për fëmijë do të fillojë zbatimin gradual, sipas grup-moshave si vijon:
 - 2.1. Duke filluar nga data 1 shtator 2021, të gjithë fëmijët e lindur në vitin 2020 dhe vitin 2021 mund të marrin shtesa;
 - 2.2. Duke filluar nga data 1 janar 2022, të gjithë fëmijët e lindur nga 1 janari i vitit 2018 e deri në vitin aktual, mund të marrin shtesa;
 - 2.3. Duke filluar nga data 1 korrik 2022, të gjithë fëmijët e lindur nga 1 janari i vitit 2015 e deri në vitin aktual, mund të marrin shtesa;
 - 2.4. Duke filluar nga data 1 janar 2023, të gjithë fëmijët e lindur nga 1 janari i vitit 2012 e deri në vitin aktual, mund të marrin shtesa;

2.5. Duke filluar nga data 1 korrik 2023, të gjithë fëmijët nën moshën 16 vjeç mund të marrin shtesa;

3. Dinamika e shpërndarjes së shtesave për fëmijë të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij vendimi mund të ndryshojë varësisht nga hapësira fiskale.

B. FORMA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

4. Aplikimi për të përfituar nga subvencionimi i përcaktuar në pikën 1, sipas afateve kohore të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, mund të bëhet nga nëna e fëmijës. Në rastet kur nëna mungon, aplikimin mund ta bëjnë babai, ose kujdestari ligjor i fëmijës.
5. Aplikimi për të përfituar nga masa 3.5 nga nëna bëhet në mënyrë elektronike, përmes plotësimit të aplikacionit elektronik për të cilin Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve obligohet që në kohë optimale nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ta zhvillojë dhe ta publikojë.
6. Aplikimi nga babai ose kujdestari ligjor i fëmijës sipas pikës 4 të këtij vendimi, bëhet përmes postës elektronike, për të cilën Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve obligohet që ta publikojë në kohë optimale nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke bashkëngjitur dokumentet si në vijim:

- 6.1. Certifikata e lindjes së fëmijës ose ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile;
- 6.2. Dëshmia që aplikuesi/ja është kujdestar ligjor i fëmijës;
- 6.3. Konfirmimi bankar i xhirologarisë së aplikuesit/es; dhe
- 6.4. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit/es.

C. KUFIZIMET NË SUBVENCIONIM

7. Të gjitha aplikacionet që nuk përmbajnë të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar sipas këtij vendimi, do të refuzohen.
8. Çdo aplikim i dyfishtë për të përfituar nga masa 3.5, do të refuzohet.

D. APROVIMI DHE FINALIZIMI I LISTËS SË PËRFITUESVE

9. Lista finale e të kualifikuarve si përfitues nga masa 3.5 konfirmohet nga Komisioni që themelohet përmes miratimit të një vendimi të veçantë nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.

10. Komisioni nga pika 8 e këtij vendimi, listën finale me të dhënat e përfituesve dhe shumën totale të aprovuar, pas regjistrimit të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës e procedon tek Thesari për ekzekutim.

E. ZBATIMI I VENDIMIT PËR SUBVENCIONIM

11. Pas aprovimit të listës së përfituesve, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogari bankare të përfitueseve.

12. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

F. HYRJA NË FUQI

13. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Hekuran Murati
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Vendimi i'u dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; dhe
- Arkivit të MFPT-së.